

UDHËZIM
Nr.1, datë 10.12.2003

**PËR ADMINISTRIMIN E PASURISË SHTETËRORE NË PËRDORIM TË
ORGANIZATAVE TË MENAXHIMIT TË PESHKIMIT (OMP)**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, si dhe në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.151, datë 13.3.2003 “Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të porteve të peshkimit në Vlorë dhe në Sarandë dhe për miratimin e marrëveshjes tip të kalimit në përdorim të porteve të peshkimit tek Organizatat e Menaxhimit të Peshkimit (OMP)”,

UDHËZOJMË:

1. Ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë u jep në përdorim (pa pagesë) Organizatave të Menaxhimit të Peshkimit (OMP) portet e peshkimit dhe infrastrukturën përkatëse sipas çdo urdhri nominal të Ministrit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit. Vlerësimi i objekteve në inventarin e dorëzimit të bëhet sipas rregullave të përcaktuara në vendimin e Këshillit të Ministrave, nr.159, datë 13.3.2003 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet, si dhe për procedurat e shitjes”.

2. OMP-ja, gjatë përdorimit të kësaj pasurie shtetërore, të mos ndryshojnë qëllimin dhe destinacionin e përdorimit të saj.

Ndryshim destinacioni konsiderohet:

- përdorimi i ambienteve për qëllime jashtë objektit të veprimtarisë së OMP-së, parashikuar në nenet 6 dhe 7 të marrëveshjes tip;

- dhënia me qira e objekteve, shesheve dhe pasurisë tjetër shtetërore, subjekteve joanëtare të shoqatës.

Ndryshimi i qëllimit dhe i destinacionit të përdorimit të kësaj pasurie shtetërore i jep të drejtë ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë që të prishë në mënyrë të njëanshme dhe të menjëhershme marrëveshjen tip me OMP-në përkatëse.

3. Në rastet kur OMP-ja disponon ambiente të tepërta, ato i vihen në dispozicion ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë, e cila mund t’i përdorë vetë ose t’i japë me qira, konform dispozitave ligjore në fuqi.

4. Organizata e Menaxhimit të Peshkimit, sipas pikave 9 e 10 të marrëveshjes tip “Për transferimin në përdorim të portit të peshkimit ..”, ka për detyrë të sigurojë ruajtjen e pasurisë shtetërore që i është dhënë në përdorim, si dhe rritjen e vlerës ekonomike të saj.

Ruajtje dhe rritje e vlerës ekonomike të kësaj pasurie shtetërore do të konsiderohet:

- sigurimi i detyrueshëm i pasurisë tek kompanitë e sigurimeve, me qëllim shmangien e rrishtit nga dëmtimet;

- organizimi i ruajtjes së objekteve dhe pasurisë tjetër shtetërore nëpërmjet kompanive të specializuara të ruajtjes së pronave (policia private) ose me punonjësit e tyre;

- riparimet dhe mirëmbajtjet e zakonshme dhe të vazhdueshme të tyre.

- kryerja e investimeve për rritjen e kapaciteteve, mekanizimin, automatizimin dhe modernizimin e teknologjive nëpërmjet përdorimit me efektivitet:

a) të fondit të amortizimit, i cili llogaritet dhe përdoret nga OMP-ja;

b) të ardhurave nga aktiviteti i kësaj Organizate, sipas nenit 28 pika 2/b e statutit.

Për të gjitha këto investime, OMP-të duhet të marrin paraprakisht miratimin nga Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit, nëpërmjet ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut, Sarandë.

5. Me dorëzimin e objekteve nga OMP-të, ndërmarrjes së rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut, pas përfundimit të kontratës së përdorimit ose në raste të tjera kur janë objekt i saj, dhe kur këto objekte nuk do t’i jepen më OMP-së në përdorim të mëtejshëm, për investimet e kryera nga kjo e fundit, do të veprohet si më poshtë:

a) Vlera e investimeve për ndreqje themelore nuk llogaritet dhe nuk paguhet nga ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjeve dhe peshkut.

b) Investimet që kanë të bëjnë me objekte të reja ose me rritjen e kapaciteteve të atyre ekzistuese dhe kur ato janë përfshirë në vlerën e këtyre objekteve, si shtesë kati, etj., i paguhen OMP-së nga ana e NRZMP-së, me vlerën e mbetur sipas kontabilitetit ose vlerësimit të bërë nga ekspertë të pavarur.

c) Për investimet e tjera të karakterit të objekteve të lëvizshme, si linja teknologjike, fabrika etj., dhe që nuk janë përfshirë në vlerën e objekteve ekzistuese, çmontohen nga ana e OMP-së, pa prishur anën funksionale të ndërtesës.

6. Drejtoria e Peshkimit, Drejtoria e Kontrollit Financiar pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë, në zbatim të nenit 31/11 të ligjit nr.8870, datë 21.3.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.7908, datë 5.4.1995 “Për peshkimin dhe akuakulturën” ngarkohen të kontrollojnë:

- dokumentacionin e transferimit të porteve të peshkimit nga ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë tek OMP-ja;

- mënyrën e përdorimit nga OMP-ja të kësaj pasurie shtetërore.

7. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen drejtoritë përkatëse pranë Ministrisë së Bujqësisë dhe të Ushqimit, projekti pilot i zhvillimit të peshkimit, ndërmarrja e rritjes dhe zënies së midhjes dhe peshkut Sarandë dhe OMP-të.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Për Ministrinë e Bujqësisë dhe të Ushqimit
Agron DUKA

Për Ministrinë e Ekonomisë
Arben MALAJ